

## ZBATIMI I METODËS ANALITIKE-SINTETIKE NË ABETAREN E PROFESOR XHEVAT GEGËS

Figurat e ndritura të arsimit, dijes, kulturës, shkencës dhe historisë së një populli nuk mund të shuhen aq lehtë, meqenëse vlerat dhe gjurmët që kanë lënë ndër vite janë aq të mëdha dhe të panumërta, sa që emri i tyre është sinonim në çdo bisedë që lidhet në çdo sferë të jetës.

Historia jonë kombëtare do t'i kujtojë ata patriotë, mësues, poetë, mendimtarë që asgjë nuk kursyen për shqiptarinë, ata që për ne janë fytyrat më eminente të historisë sonë kombëtare. Ata që rilindën shpresën për një gjuhë, për një komb, për një shkollë shqipe, rilindësit e shqiptarizmit, si: Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Jani Vreto, Zef Jubani, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jeronim de Rada, Hasan Tahsini, Thimi Mitko, Aleksandër Xhuvani, Ndue Paluca, Jani Minga, Mati Logoreci, Gaspër Benusi, Lumo Skendo, Jani Risto Terova e deri te më të rinjtë, si Qamil Guranjaku, Kol Xhumari, Qamil Batalli, Mehmet Gjevori etj.<sup>1</sup>

Në mesin e këtyre figurave nuk ka se si të mungojë edhe emri i profesorit të nderuar Xhevat Gega. Ai, me dijen dhe përvojën e tij la një fond të pasur në thesarin e bibliotekës shqiptare, krijoi një traditë, vuri themelet në disa metoda të shkrim-leximit të gjuhës sonë, duke krijuar në brezni të tëra kënaqësinë e përvetësimit të shprehive të leximit dhe të shkrimit të gjuhës amtare, duke vënë në duart e qindra e mijëra të miturve shqiptarë, librin që u mësonte lexim-shkrimin shqip, pra librin e quajtur Abetare.

Viti 1970 është ogurbardhë për shqiptarët e Maqedonisë. Në këtë vit prof. Gega hartoi librin e titulluar *"Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës."* Me botimin e Abetares, profesori Gega u ra këmbanave të një epoke të re për shkollën shqipe në Maqedoni, për didaktikën e arsimit fillor, duke konceptuar drejt nevojën urgjente të kohës.

Abetarja e prof. Gega është fryti i një veprimtarie të gjerë dhe të larmishme arsimore, pedagogjike, profesionale-shkencore. Gjatë gjithë kohës sa punoi e veproi rrethanat diktuan që profesori ynë i nderuar të merret me çështje të ndryshme shkencore, arsimore, kulturore etj. Fillimisht duke punuar si mësues në shkollë fillore, të mesme, e më pas si ligjërues në universitet; përkthyes; hartues teksetesh mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollë fillore dhe të mesme; bashkëpunëtor në përgatitjen e plan-programeve mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe; bashkëpunëtor në seminare për ngritjen permanente të arsimtarëve për shkollat e

---

<sup>1</sup> [https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB\\_Mesonjetorja.pdf](https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB_Mesonjetorja.pdf)

mesme me tema të ndryshme nga fusha e letërsisë dhe metodikës së mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe, të organizuar nga ana e Entit Pedagogjik Republikan të Maqedonisë etj.

S'do mend se një personalitet me një bagazh kaq të pasur shkencor-kulturor dhe me njohuri të jashtëzakonshme në fushën e arsimit do na linte si trashëgimi një Abetare kaq të çmuar, e cila edhe pas gjysmë shekulli frymon po me të njejtën vlerë dhe rëndësi.

### **a) Rëndësia gjuhësore, didaktike dhe edukative e Abetares së prof. Xhevat Gegës**

Abetarja e profesorit Xhevat Gega është një dokument me shumë rëndësi për gjuhën shqipe, për historikun e shkrimit dhe të përdorimit të saj në shkollë, për edukimin dhe arsimin e fëmijëve shqiptarë në Maqedoni, por edhe më gjerë. Në këtë Abetare, sikurse edhe në Abetaret kudo në botë, shfaqet tharmi kombëtar, kjo ndjenjë kombëtare vjen si domosdoshmëri e gati mbijetesë referuar kushteve historike në të cilat ajo është hartuar.

Hartimi i librave shqip dhe i Abetares shqipe tregon vullnetin e mirë dhe ndërgjegjen e lartë atdhetare të autorit. Prof. Gega me kompetencën e një dijetari shkel në disa shtigje të vështira dhe përgjithësisht të parrahura apo të rrahura fare pak në Maqedoni. Në një kohë kur tradita e hartimit të teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut ishte e paktë, profesori Gega arriti të hartojë tekst të unifikuar që kanë pasur mundësi ta kuptojnë dhe përdorin si nxënësit e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe ata të Kosovës dhe të Shqipërisë. Kjo dëshmon se, ai ka qenë metodist i mirë, mjeshtër i denjë e mbi të gjitha mësues praktik, se ka njohur në thelb traditën e shkrimit shqip. Nëse sot luftohet për një Abetare të unifikuar Shqipëri-Kosovë-Maqedoni, një nxënës i Maqedonisë së Veriut që në vitet e '70-ta përmes Abetares së profesorit Gega e ka pasur një mundësi të tillë.

Pra, prof. Gega me hartimin e Abetares kontribuoi në unifikimin e gjuhës shqipe për mbarë trevat shqipfolëse, për të pasur një kod të lexueshëm dhe të kuptueshëm për të gjithë, në një kohë kur mungonin standardet në lëndën e gjuhë dhe të leximit letrar. Kjo pjesë e veprimtarisë së tij lidhet me nevojën e kohës, për ta shkruar gjuhën shqipe me germa të vetat, autentike. Abetaja ishte libri që ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni *"ishte arma më e fuqishme për të shkëputur arsimin tonë nga varësia e arsimit në*

*gjuhë të huaj. Me përmbajtjen e saj, ajo ndikoi fuqishëm në edukimin e gjeneratave të tëra me ndjenjat më të larta atdhetare dhe fisnike.*<sup>2</sup>

Abetaren e prof. Gega mund ta konsiderojmë si vepër historike, kulturore, arsimore, linguistike, patriotike, e cila u hapi rrugën teksteve mësimore në gjuhën shqipe në Maqedoni por edhe më gjerë, duke u dhënë autorëve pasardhës modelin e shkëlqyer të Abetares, si libër fillestar për mësimin e shkrim-leximit. Me botimin e Abetares prof. Gega dëshmoi se vlera e një vepre nuk qëndron aq në vëllimin e saj, sesa në rrugën që hap e në idetë që përçon.

Në tekstin "*Abetare-zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës*", dëshmohet punën e prof. Gegat edhe si një linguist i denjë, copat e leximit dallohet nga aspekti gjuhësor për qartësinë e shprehjes dhe pastërtinë e gjuhës. Brenda faqeve të Abetares nuk ndeshim shprehje abstrakte dhe konfuze që e detyrojnë nxënësin ta mësojë leximi-shkrimin përmes kujtesës mekanike, por ndodh e kundërta, çdo frazë ose copë leximi lexohet dhe mësohet përmes kujtesës logjike.

Në Abetare ka një organizim të kombinuar të mësimin të leximit dhe të shkrimit fillestar, i cili ecën sipas hapave metodikë të mësimin të shkronjave, duke evidentuar veçoritë grafike dhe ato fonetike të tyre, si bukurshkrimin edhe ortografinë. Një kujdes të veçantë prof. Gega i ka kushtuar drejtshkrimit të grupeve të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve, përdorimit të theksit etj. Te fjalët që e kanë theksin në rrokjen parafundore, autori nuk vendos asnjë shenjë, pasi theksin parafundor e merr si model theksor të zakonshëm të fjalëve të shqipes. Kështu, faktori didaktik lidhet me: njohjen e shkrimit me sy, shqiptimin e fjalëve dhe me kuptimin e tyre.

Përkritazi me këtë, profesori Gega ndalet edhe në përdorimin e shenjave të pikësimit. Përmes copave të leximit synon që mësuesi, përveç të lexuarit dhe të shkruarit të gjuhës amtare, t'u mësojë nxënësve edhe: pikën, pikëpresjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen, dy pikat, vizat, kllapat, thonjëzat, tri pikat, paragrafet e kështu me radhë. Nëpërmjet udhëzimeve të shkurtra, krijon një terminologji gramatikore shqiptare, e cila ka zënë vend në traditën tonë gramatikore.

Karakteri edukativ i Abetares nuk është më i paktë se ai arsimor e kombëtar. Me përmbajtjen e saj, kjo Abetare ka shërbyer tri dekada me radhë si mjet i fuqishëm për edukimin etik, estetik dhe artistik të fëmijëve në këtë etapë të parë të shkollimit të tyre. Ana edukative jetësohet përmes figurave dhe tablove të Abetares, në bazë të bisedave dhe përshtypjeve të

---

<sup>2</sup><https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-shefik-osmani-prof-as-dr-njazi-kazazi-abetaret-e-para-shqipe-dhe-trajektorja-historike-e-tyre/>

drejtëpërdrejta nga jeta, puna, natyra, shoqëria, shkolla etj., duke ngjallur te nxënësit dashurinë për atdheun, gjuhën amtare, shkollën, për punën, shokun etj. Njëkohësisht, u zgjon atyre ndjenjën e urrejtjes për çdo gjë të keqe e të shëmtuar, urrejtjen për armikun, dembelizmin, intrigën, thashethemet etj.

Prof. Gega me botimin e Abetares dha ndihmesë të madhe në shumë drejtime, para se gjithash: ndihmoi në zhvillimin dhe pasurimin e fjalorit dhe kulturës folëse të nxënësve nismëtar të shkollës fillore; shtoi numrin e fjalëve dhe përdorimin e drejtë të tyre në praktikën e komunikimit të përditshëm gjuhësor; korrigjoi trajtat e të folmes lokale; ushtroi të folurit dhe gjuhën e normuar; ndihmoi edhe në përvetësimin gradual të diturive të para nga gramatika dhe drejtshkrimi etj.

## **b) Struktura e Abetares**

Abetarja konsiderohet si libri më i rëndësishëm në jetën shkollore të një nxënësi, ajo u mëson nxënësve të lexojnë me kuptim tregime e tekste të ndryshme me karakter letrar e jo letrar, të shkruajnë tekste të shkurtra, fjali, fjalë dhe ushtrime të ndryshme me karakter analitik, sintetik dhe krijues.

Libri *"Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"* i profesorit Xhevat Gega është me paraqitje të bukur dhe ilustrime dinjitoze. Ajo është moderne, bashkëkohore, cilësore dhe me nivel shkencor e pedagogjik, pavarësisht se ka kaluar gjysmë shekulli që nga botimi i parë. Këto vlera dhe merita u dëshmuar me ribotimet e shumta që pësoi dekada me radhë. Një pasqyrë kronologjike e ribotimeve të Abetares së profesorit Xhevat Gega duket si vijon:

1. *"Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"*, Xhevat Tahir Gega, Shkup, Prosvetno Dello, 1970, 1971, 1973, 1975, 1976.

2. *"Abetare: zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"*, Xhevat Gega, Shkup, Prosvetno dello, 1978, 1979, 1986, 1987, 1989, 1990, 1991, 1998, 1999, 2000.

Botimi i parë është titulluar *"Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"*, d.m.th. janë mësuar paralelisht edhe shkronjat e shtypit edhe të dorës, por ky titull ka figuruar deri në ribotimin e vitit 1976. Në ribotimet që fillojnë nga viti 1978-2000 ndryshon emërtimi, radhitja dhe stuktura. Libri titullohet *"Abetare - zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"* pra, në fillim mësohen të gjitha shkronjat e shtypit dhe më pas të dorës.

Ndryshime në përmbajtjen e librit dhe në temat që janë veçuar për t'u punuar vërejmë në botimin e vitit 2000, krahasuar me ribotimin e tri dekadave më parë, shohim se pjesa dërmuese e temave ndryshojnë dukshëm për nga përmbajtja, hera-herës hasen ndryshime në radhitjen e shkronjave e të ilustrimeve.

Ky fakt dëshmon se profesori Gega vazhdimisht është ngritur profesionalisht dhe shkencërisht për të qenë në hap me kërkesat e kohës, duke e pasuruar dhe përsosur vazhdimisht, ngase edhe vet Abetarja ka një rol të tillë, ajo duhet të jetë sa më e bukur, tërheqëse dhe argëtuese, që ta mbushë fëmijën plot me gëzim për faktin që ka ardhur në shkollë apo që po mëson të lexojë e të shkruajë shqip.

Kjo Abetare e realizon synimin e saj nëpërmjet metodave dhe formave pedagogjike e psikologjike nga më të ndryshmet. Ajo është mjaft e kompletuar. Materiali i leximit është në forma të ndryshme, si: tregime, poezi, lojra të shumta, nga krijimtaria popullore ka përralla, anektda, këshilla moralizuese etj.

Në përzgjedhjen e copave të leximit që ka përdorur në Abetaren e tij, profesori Gega, duke respektuar kriteret e programit, ka zgjedhur krijime vërtet të arritura, si nga ana artistike, ashtu edhe nga ajo ideore. Në Abetare ndeshim mesazhe të fuqishme humaniste, mesazhe të mirësisë dhe bujarisë, mesazhe të paqes dhe tolerancës, mesazhe të punës dhe, mbi të gjitha, mesazhe të dashurisë ndërnjerëzore në të gjitha format e saja. Të gjitha këto vlera janë menduar se duhet t'i jepen një brezi që është në zhvillim për ta formuar identitetin e tij, për të qenë krenar për historinë, kulturën, traditën dhe përkatësinë e tij kombëtare. Shembuj të kësaj natyre kemi në copat e leximit: "*Thimi në mulli*", faqe 53; "*Punëtori i mirë*" faqe 95, "*Qaniu mekanik*", faqe 48, "*Pali zejtar*" faqe 76, "*Ç'do të bëhem*" faqe 77, "*Punëtori*" faqe 76, ku prof. Gega me mjeshtëri na njofton mbi dashurinë dhe dëshirën që kanë fëmijët për punën.

Dashurinë për atdheun e hasim në pjesët e leximit: "*Liria është e shenjtë*" faqe 58, "*Republikës*" faqe 59, "*Flamuri i kuq*" faqe 101.<sup>3</sup>

Duke dashur të ngjallë dashurinë për shkollën si vendi më i dashur ku nxënësit edukohen, argëtohen e mbi të gjitha arsimohen, nëpërmejt pjesës së leximit: "*Shkolla ime*" faqe 77, "*Askush s'ka shokë sa unë*" faqe. 60, prof. Gega arrin ta realizojë një qëllim të tillë. Një vend të veçantë zënë tregimet ku ushqehet dashuria për mësuesen, ku me fjalët më të ëmbëla përshkruhet kjo ndjenjë fisnike. Shembuj të tillë na ofrojnë copat e leximit: "*Klasa jonë*" faqe 81, "*Mësuesja*

---

<sup>3</sup> Shembujt e lartpërmendur janë marrë nga botimi i parë i Abetares e vitit 1970.

jonë" faqe 86, "Shkronja Zh" faqe 106. Dashuria ndaj prindërve pasqyrohet me shumë kujdes në vjershat: "Nënë e baba unë i dua" faqe 69, "Nëna", faqe 72, "Nënë, u rrita" faqe 87.

Respektin ndaj të moshuarve e gjejmë në tregimet: "Një plak" faqe 52 dhe "Tre shokë" faqe 72. Në Abetare nuk mungojnë edhe këshillat moralizuese, të cilat me mjeshtëri janë për zgjedhur për t'u paraqitur në tregimet: "Dhelpra para gjyqit" faqe 103 dhe "Macja dhe miu" faqe 71. Në disa faqe të Abetares, prof. Gega na jep si model fjalë të urta dhe shprehjet edukative, të cilat ndikojnë në ngritjen e ndërgjegjes dhe moralin e nxënësit, si p.sh.: *Punë, punë natë e ditë që të shohim pakëz dritë!* faqe 76; *Libri është shoku më i mirë i jetës!* faqe 60, *Puna e nderon njeriun!* faqe 77; *Mësim, mësim e vetëm mësim!* faqe 88; *Liria është shoku më i mirë i jetës!* f. 99.

Një nga anët më të forta të Abetares është lidhja e fuqishme ndërlëndore. Teksti krijon lidhje të ngushta me lëndën e matematikës. Disa herë nxënësit i duhet të numërojnë, të krahasojë, të klasifikojë apo të plotësojë tabela. Shembuj të kësaj natyre paraqiten në faqen 38, 42, 98; por jo të grupuara në mësim të përbashkëta për njohuritë matematikore, por të integruara në mësimet e abetares, si p.sh., numrat nga 1-4, mbledhje (dy plus dy sa bëjnë?; (një edhe një bëjnë dy); shumëzimi (3 herë 1 bëjnë tre; 5 herë 1 bëjnë 5).

Lidhja me letërsinë realizohet përmes shembujve të letërsisë artistike. Ndërthurja e këtyre njohurive me tekstet eseistike dhe ndërtimi i pyetjeve dhe ushtrimeve synojnë aftësimin praktik të nxënësve për të konkretizuar në shkrimet e tyre njohuritë gjuhësore.

Lidhja e nxënësit me pikturën sigurohen nëpërmjet ushtrimeve të shumta që kërkojnë herë të vizatohet një objekt e herë të ngjyroset, si edhe nga ilustrimet e shumta të bukura që figurojnë në abetare.

Për renditjen dhe mësimin e tingujve dhe shkronjave, në Abetare profesori Gega u ka kushtuar rëndësi parimeve të njohura në metodologjinë bashkëkohore të hartimit të Abetareve, siç janë: parimi i vështirësisë shqiptimore të tingujve (parimi fonetik); parimi i vështirësisë grafike të shkronjave; parimi i dendurisë ose frekuencës së përdorimit të tingujve në gjuhën e folur e të shkruar. Mësohen më parë tingujt që shqiptohen më lehtë dhe shkronjat me strukturë grafike më të thjeshtë, si p.sh. fillohet me shkronjat *A, M, I, U, N, E, L, R, Ë, K, O, T.....* (f. 24-35), e më pas vazhdohet me shkronjat më të ndërlikuara si: *P, D, B, J, S, H, Y, F, V, C* (f. 36-45) e për të pasuar më tej me shkronjat *G, LL, Q, Sh, Rr, Nj, Gj, Th, Dh, X, Z, Zh*, f. 46-55.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Radhitja e lartpërmendur i referohet ribotimit të fundit të Abetares, viti 2000.

Renditja dhe mësimi më parë i tingujve dhe shkronjave me shkallë më të lartë përdorimi në komunikimin e përditshëm në të folur dhe shkruar mundëson që fëmijët nismëtar të shkollës fillore, brenda një kohe më të shkurtër të aftësohen të flasin dhe të shkruajnë.

Parimi udhëheqës i fotografimit të figurave-fjalë dhe të fjalive-figurë, si dhe i fjalëve kyçe është një kritër që respektohet në këtë Abetare dhe që ndihmon në mënyrë të ndjeshme në kapërcimin e vështirësive të para tek nxënësit, të tilla si ato të përdorimit të fjalëve kyç dhe lidhëse, apo siç janë foljet e para që duhen përdorur, si: *ka, kam, jam, luan*; fjalëzat *me, në* etj. Njohja pamore e strukturës së këtyre fjalëve jep dorë për lidhjen logjike të fjalëve në struktura fjalish, fillimisht të thjeshta e më pas edhe më të zgjeruara.

Parimi i rimarrjes zë vend të dukshëm në Abetare. Ai nis me rimarrjen e shkronjave në çdo faqe të librit dhe më pas vijon me rimarrjen për analizë të fjalëve të vështira, si dhe të fjalëve me probleme drejtshkrimore, kryesisht me ato grupe shkronjash tri-katër rrokëshe, si dhe me rrokje të vështira (të mbyllura) për t'u përvetësuar nga nxënësit që në çastin e parë të paraqitjes së tyre. Rimarrja zë një vend të rëndësishëm edhe gjatë punës me shkronjat, në çdo 6 shkronja bëhet një rimarrje: në këto çaste, nxënësit ushtrohen për të lexuar tekste të ndryshme dhe për të bërë ushtrime sinteze e analize të fjalëve e fjalive të veçanta, të rimarra nga mësimet e mëparshme, pa përjashtuar ato të rejat.

### **c) Zbatimi i metodës analitike-sintetike**

Për problemin e të mësuarit të lexim-shkrimit të fëmijët, mendime të ndryshme dhe mbarëkombëtare ngulin këmbë me të drejtë se, për mësimin e tij të përdoren metoda jo të improvizuara, por metoda që kanë vlerë të sigurt shkencore, të jenë eksperimentuar gjerësisht dhe që mund të japin garanci për suksesin dhe që kanë të bëjnë me arritjen dhe përvetësimin e disa aftësive e mjeteve që lidhen me teknikën e leximit dhe të shkrimit.

Po cilat janë tipat e metodave që janë përdorur historikisht dhe të atyre që kanë të bëjnë me kërkimet që janë bërë dhe po bëhen aktualisht? Më shumë se për metoda të veçanta, këtu mund të flitet për prirje metodologjike, d.m.th. për një grup metodash të cilat me gjithë ndryshimet që kanë midis tyre, kanë të përbashkët një skemë, një substrat, një procedim e një mbështetje shkencore. Të tilla grupime metodologjike janë në një numër të kufizuar, por brenda tyre mund të dallojmë një numër të madh metodash specifike me variante të përbashkëta, mbi një skemë referimi, që bën të mundur futjen e tyre në një grup të gjerë.

Hulumtimet në fushën e psikologjisë së edukimit kanë provuar se leximi dhe shkrimi, si procese psiko-fiziologjike, kanë rrjedhë të kundërt, njëri është analitik (leximi) dhe tjetri sintetik (shkrimi). Bazuar në këtë kriter në Konferencën e 12-të Ndërkombëtare për Edukim Publik të UNESCO-s e të Byros Ndërkombëtare për Edukim, u miratua klasifikimi i metodave të mësimin të leximit-shkrimit fillestar në këto tri grupe bazë:<sup>5</sup>

1. *Metoda sintetike (këtu përfshihen edhe ato fonetike, globale);*
2. *Metoda analitike;*
3. *Metoda analitike-sintetike;*
4. *Metoda mikse.*

Varianti më i përhapur dhe më i zbatueshëm në mësimin e lexim-shkrimit fillestar në shkollat tona është metoda analitike-sintetike e tingullit, që i përshtatet më mirë natyrës së gjuhës shqipe. Mbështetur në këtë metodë, profesori Xhevat Gega e ka hartuar tekstin "*Abetare - zhvillim veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*", pra orientimi metodologjik në këtë abetare është drejt metodës analitike-sintetike.

Zbatimin e metodës analitike-sintetike në "*Abetare - zhvillim veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*", profesori Xhevat Gega e jetësoi përmes tri periudhave kryesore:

- a) *periudha përgatitore për lexim-shkrim, ndryshe e quajtur **Paraabetarja**;*
- b) *periudha e dytë lidhet me mësimin e shprehive themelore të teknikës së lexim-shkrimit, ndryshe e quajtur **Abetarja**;*
- c) *Periudha e tretë lidhet me përforcimin e teknikës së lexim-shkrimit, kjo periudhë ndryshe njihet si **Pasabetarja**.*

1. *Periudha përgatitore për lexim-shkrim - Paraabetarja* fillon që ditën e parë të ardhjes së fëmijës në shkollë dhe zgjat rreth dy javë. Qëllimi është që gjatë kësaj periudhe nxënësi të përgatitet për të mësuar shkrimin dhe leximin sipas metodikës analitike-sintetike. Prandaj, në këtë periudhë mësuesi duhet të punoj në shumë drejtime, me qëllim që t'i nxisë dhe zhvillojë të gjitha aftësitë e fëmijëve dhe t'u zgjojë atyre interesin për mësimin e shkrim-leximit. Duke i dhënë karakter emocional e të gëzueshëm mësimin në këtë periudhë, mësuesi nxit vëmendjen dhe interesimin e nxënësve, i përgatit ata gradualisht që të kalojnë nga loja (që në periudhën parashkollore ishte forma kryesore e veprimtarisë së tyre) te puna e disiplinuar. Gjithashtu, në këtë periudhë, duhet bërë një punë këmbëngulëse për ta përgatitur nxënësin që të jetë në gjendje

---

<sup>5</sup> [https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha\\_Shqipe/3.pdf](https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha_Shqipe/3.pdf)



të perceptojë sa më mirë realitetin. Bëhen ushtrime për zhvillimin e të vëzhguarit, të dëgjuarit, të shqiptuarit, si dhe për shkathtësimin e dorës, sidomos të gishtërinjve për të mbajtur lapsin dhe për të lëvizur në drejtime të ndryshme gjatë shkrimit. Nga faqja 4-23 të Abetares, prof. Gega ka paraqitur materiale shumë të bukura për këtë qëllim, siç janë figurat e ndryshme, skicat dhe vizatimet, elementet e shkronjave në nënpletat e Abetares, materiale për dëgjimin e fjalëve një, dy ose trirrokëshe, për shqiptimin dhe dëgjimin e tingujve e kështu me radhë.<sup>6</sup>

Në fazën e dytë të kësaj periudhe profesor Xhevati i orienton nxënësit drejt mësimin të fjalisë së thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore dhe asaj të zgjeruar me një fjalë plotësuese. Shumë të përshtatshme për këtë qëllim janë figurat e dhëna në faqet 6, 9, 10 ku nxënësit me ndihmën e mësuesit, duke u bazuar në figurat krijojnë fjali me dy e me tre fjalë, e pastaj i ndajnë fjalët e fjalisë. Më tej, duke u mbështetur në figurat e faqeve 11-14 nxënësit ushtrohen edhe për ndarjen e fjalës në rrokje, d.m.th. për analizën e fjalës në pjesë përbërëse më të vogla. Kështu, në etapën përgatitore nxënësit mësojnë se ligjëratat përbëhet nga fjalitë, fjalitë nga fjalët, fjalët nga rrokjet dhe rrokjet nga tingujt.

Ndër detyrat kryesore të periudhës përgatitore është edhe zhvillimi i ligjeratës së nxënësve. Ndër format më të përshtatshme që na ka ofruar prof. Gega është shfrytëzimi i figurave që pasqyrojnë aspekte të veçanta nga veprimtaria e një njeriu, tiparet e një kafshe a sendi. P.sh. duke e parë figurën e parë që gjendet në faqen 7 të Abetares nxënësi thotë: *Dritani ngrihet nga shtrati*. Për figurën e dytë thotë: *Dritani bën gjimnastikën e mëngjesit*, e kështu me radhë vazhdon për të gjitha figurat e paraqitura. Në këtë mënyrë, mësuesi u bën me dije nxënësve se çdo figurë paraqet një mendim, çdo figurë mund ta përshkruajmë me fjalë dhe se fjalët e lidhura mes tyre për nga kuptimi do t'i quajmë fjali.

Punën sistematike për ndarjen e fjalës në rrokje prof. Ggega e fillon në faqen 27 të Abetares. Forma e punës që ka zbatuar profesori për të zbuluar para nxënësit rrokjen është shumë e përshtatshme, pasi i nxit nxënësit që duke krahasuar shqiptimin e dy fjalëve, të arsyetojnë dhe me ndihmën e mësuesit, të nxjerrin konkluzionin duke përcaktuar rrokjen e parë dhe rrokjen e dytë të këtyre fjalëve.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 10.

<sup>7</sup> S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 13.

Pas përforsimit të nocionit të ndarjes së fjalës në rrokje, vjen identifikimi i tingullit. Identifikimi i tingullit është një lloj veprimi fare abstrakt për moshën e fëmijëve 6-7 vjeçarë, pasi tingulli si element përbërës i fjalës, duke mos patur asnjë kuptim në vetvete, mezi mund të kapet prej nxënësve. Puna për dhënien e nocionit si dhe për të përgatitur nxënësin për identifikimin e tingullit fillon qysh në periudhën përgatitore dhe vazhdon deri në fund të Abetares. Vetëm atëherë kur nxënësi, me ndihmën e mësuesit, arrin ta veçojë tingullin nga rrokja ose fjala, ai e kupton se tingulli është pjesë përbërëse e rrokjes dhe e fjalës dhe vetëm atëherë mund të fillojë të mësojë të lexojë e të shkruajë. Për ta bërë më të kapshëm këtë proces, prof. Gega në abetare ka pasqyruar tri modele pune për veçimin e tingullit:

1. Mënyra e parë e analizës bëhet duke shqiptuar qartë fjalën në rrokje, pastaj rrokja që ka tingullin e ri shqiptohet duke ia zgjatur tingujt. Në qoftë se duam të veçojmë tingullin *m* marrin p.sh. fjalën *mama*, këtë fjalë e shqiptojmë rrokje më rrokje si (ma-ma), pastaj u themi nxënësve të dëgjojnë me vëmendje shqiptimin e rrokjes *ma*. Mësuesi e shqipton rrokjen ngadalë, duke i zgjatur tingujt *mmmaaa*, për ta përkapur atë sa më mirë.

2. Mënyra e dytë e analizës bëhet duke e veçuar tingullin e ri në fund të fjalës. Tingujt që të mund të veçohen më lehtë në këtë mënyrë janë, p.sh.: tingulli *j* i cili mund të veçohet nga fjalët *kuaj*, *muaj*; tingulli *p* nga fjalët *top*, *shkop*. Shqiptimi i këtyre fjalëve duhet të bëhet duke e artikuluar qartë tingullin e fundit të fjalës.

3. Mënyra e tretë e analizës mund të bëhet më fjalë ku tingulli që duam të veçojmë të jetë në fund, sikurse për mënyrën e dytë, por me ndryshim që fjala shqiptohet nga mësuesi me mungesë të tingullit të fundit, për t'u plotësuar nga nxënësit. Për të veçuar tingullin *k* nga fjala *shok*, mësuesi thotë se do të shqiptojmë fjalën *shok* dhe në atë çast shqiptohet vetëm *sho*, duke pritur që fjala të plotësohet me tingullin *k* nga fëmijët. Fëmijët e plotësojnë duke shqiptuar *k*-në.

Pas analizës së tingujve kalohet në një fazë tjetër, në atë të sintezës së tingujve. Për t'i prerë rrugën leximit sipas mënyrës jo të përshtatshme të bashkimit të shkronjave, prof. Gega në "Abetaren - zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës" ka përdorur këto forma pune për sintetizimin e tingujve:

1. Leximi i rrokjes dhe i fjalës pasi të jetë bërë analiza e plotë e saj. Në këtë mënyrë lexohen të gjitha fjalët që paraqesin një farë vështirësie në të lexuar e në të shkruar e që mësuesi mendon t'i ushtrojë. Kështu, veprohet për t'i lexuar fjalët: *u-ra*, *mi-u* etj. Pas bisedës së

përgjithshme kërkohet që nxënësit t'i ndajnë në rrokje e tinguj, pastaj t'i lexojnë të plota këto fjalë. Shembuj të tillë janë pasqyruar në faqen 27 të Abetares.<sup>8</sup>

2. Leximi i plotë i rrokjeve dhe i fjalëve pasi të jenë analizuar dhe punuar më parë. Kështu, veprohet për ta lexuar të plotë ose për ta shkruar fjalën *mu-ri*. Fjala ndahet në rrokjet: *mu* dhe *ri*. Rrokja *mu* ndahet në tinguj. Nxënësit gjejnë shkronjën e tingullit të parë *m*, pastaj gjejnë shkronjën e tingullit të dytë *u*, të cilën e vendosin pranë të parës (m), kështu rrokja *mu* lexohet e plotë. Merret pastaj rrokja e dytë *ri*, bëhet analiza dhe gjendet shkronja e tingullit të parë, pastaj edhe e tingullit të dytë, pastaj lexohet si rrokje e plotë. Në fund mësuesi i afron rrokjet pranë njëra-tjetrës dhe nxënësit lexojnë fjalën *mu-ri*.

3. Leximi i rrokjeve dhe i fjalëve duke u mbështetur në ngjashmërinë e tyre me rrokjet dhe fjalët e mësuara më parë. Kështu, sipas kësaj mënyre mund të lexohet fjala *ma-ni* pas fjalës *ma-li*, fjalët *Ma-ra* dhe *Mi-ra*, shembujt janë pasqyruar në f. 31 të Abetares. Duke i lexuar fjalët sipas kësaj mënyre nxitet mendimi krijues i nxënësve dhe fitohet kohë, pasi një pjesë e fjalës lexohet drejtpërdrejt, pa punuar më parë me shkronjat e shtypit.

4. Leximi i rrokjeve të plota, duke u mbështetur në zgjatjen e tingullit të tyre bashkëtingëllor dhe në kalimin e shpejtë në zanoren që vjen pas. Veprohet kështu: Fjala *lu-le* ndahet në rrokje dhe në tinguj. Rrokja e parë shkruhet me shkronjë të shtypit. Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë bashkëtingëlloren *l* më të zgjatur dhe të mos e ndërpresin, derisa ai t'u tregojë zanoren *u* që vjen pas. Kështu lexohet më parë rrokja *lu*, pastaj *le* dhe në fund e gjithë fjala *lllu-lllle* etj. Shembuj të tillë profesor Gega ka pasqyruar në f. 30 të Abetares.

5. Leximi i rrokjeve dhe i fjalëve duke u shtuar atyre ose duke u hequr tinguj të ndryshëm nga fillimi, fundi ose mesi. Kjo mënyrë e sintezës gjen zbatim të gjerë kudo, si në mësimet për paraqitjen e tingujve e të shkronjave, ashtu edhe në ato të përpunimit të faqeve, të përsëritjes, në mësimet e shkrimit etj. Edhe në këtë mënyrë, prof. Gega na ndihmon që t'i drejtojmë nxënësit nga e njohura tek e panjohura, duke lehtësuar kështu kalimin e vështirësisë në të lexuarit e fjalëve të reja e duke kursyer kohë. Mund të veprohet kështu, p.sh.: meqenëse rrokja *ra* është e njohur, i aktivizojmë nxënësit ta shkruajnë dhe ta lexojnë. Pastaj marrim në dorë shkronjën *o-* të

---

<sup>8</sup> S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 22.

të vogël të shtypit dhe u themi nxënësve ta lexojnë. Kështu e vendosim pranë rrokjes *ra*. Nxënësit lexojnë *o-ra*.<sup>9</sup>

II. Në *periudhën e dytë të mësimit të shkrim-leximit, ndryshe e njohur si Abetarja* fëmijët duhet të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë shkronjat, të lexojnë dhe të shkruajnë fjalë që formohen me ato shkronja. Mësimi i leximit dhe i shkrimit duhet të shkojnë paralelisht dhe të mësohen njëkohësisht. Mësimi i shkrimit nuk duhet të quhet si mësimi i teknikës së shkrimit të shkronjave, por si mësim i vërtetë për të mësuarit e shkrim-këndimit. I gjithë sistemi i punës, për të mësuarit e shkrim-këndimit, mbështetet në një punë të mirë, të kujdeshme dhe sistematike për zhvillimin e të folurit të nxënësve (punë me fjalorin për pasurimin e tij, përgjigje pyetjeve, përralla, zberthimi i fjalisë në fjalë, komentim figurash, bisedë rreth fjalive dhe copave të vogla etj.). Periudhën e mësimit të shkrim-leximit prof. Gega e ndahet në tri etapa.

*Në etapën e parë* studiohen në mënyrë praktike 12 tingujt dhe shkronjat sipas radhës që janë paraqitur në Abetare. Gjatë kësaj etape vërejmë se profesori Gega ka zbatuar këto mënyra pune:

- a. zberthim fjalësh në rrokje e tinguj dhe bashkim tingujsh në rrokje e fjalë.
- b. shtim zanoresh dhe bashkëtingëlloresh në fjalë të caktuara (*ra, o-ra, mo-ra*).
- c. shkëmbim zanoresh dhe bashkëtingëlloresh ndërmjet fjalëve (*e-ra, a-ra, ma-li, me-li, te-li, me-li*).
- ç. kalim nga leximi i rrokjeve të hapura në leximin e rrokjeve të mbyllura me anë të pakësimit (*ma-li, mal*).

Fëmijët mësojnë t'i ndajnë fjalët në rrokje e tinguj dhe me rrokjet dhe tingujt të formojnë përsëri fjalët. Në çdo faqe të Abetares nxënësit komentojnë figurat, lexojnë fjalët e renditura në shtylla dhe fjalitë. Detyrë tjetër e mësuesit është që t'u zhvillojë nxënësve mënyra të drejta leximi, t'i mësojë se si t'i lidhin tingujt bashkëtingëllorë me tingujt zanorë, d.m.th. të lexojnë në mënyrë të përngjitur rrokje të hapura të përbëra prej dy shkronjash, të tipit *ra, me, ta; mi, nu, li, rri* dhe fjalë dyrrokëshe të tipit *ura, mana* dhe njërrrokëshe.<sup>10</sup>

*Në etapën e dytë* - përpunohen në mënyrë praktike 10 shkronjat dhe tingujt që vijnë sipas renditjes së Abetares. Në rrokje si vështirësi të re kanë leximin dhe shkrimin e tyre me dy

---

<sup>9</sup> S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 23-24.

<sup>10</sup> Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, *Metodika e gjuhës amtare për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore*, Prishtinë, 1971, f. 28.

bashkëtingëllore njëra pas tjetrës. Mësohen të lexojnë fjalë dyrokëshe me të dytën të mbyllur (*pu-non*), fjalë trirrokëshe të hapura (*ko-she-re, mu-sha-ma*), fjalë dyrokëshe me të dytën të mbyllur në zanoren ë (*a-rën*); fjalë dyrokëshe që fillojnë me bashkëtingëllore e që mbarojnë me zanore (*lo-dra, dhë-mbi*), por rrokjet e dyta që kanë grup bashkëtingëlloresh.

Në etapën e dytë nxënësit lexojnë tekste më të vështira që përbëhen prej 4-8 fjalish, shkruajnë fjalë dhe fjali që kanë shkronja të reja. Si rezultat i punës që bëhet në etapën e dytë, fëmijët përvetësojnë praktikisht një seri rregullash të ortografisë, si: të shkruajnë fjalë të ndara nga njëra-tjetra; të shkruajnë parafjalën veç nga fjalët; të ndajnë fjalët më të thjeshta në fund të rreshtit; të vënë pikën në fund të fjalisë; të fillojnë me shkronjë të madhe emrat e njerëzve dhe fjalitë.

**Etapa e tretë** - zhvillon në mënyrë praktike edhe 14 shkronjat dhe tingujt që vijnë sipas renditjes së Abetares. Veçori karakteristike të cilës i ka kushtuar rëndësi profesori Xhevat Gega në këtë etapë është rrënjosja e shkathtësisë për të lexuar dhe shkruar fjalë me 3-4 rrokje të vështirësive të ndryshme. Në fillim të etapës së tretë, nxënësit duhet të lexojnë lirisht rrokjet e hapura dhe të mbyllura me shkronjat që kanë mësuar. Gjatë punës me tinguj është mirë të bëhet krahasimi i disa tingujve si, p.sh. **f** me **th**, **s** me **z**, **l** me **ll**, **ll** me **dh** etj.

Një vëmendje e veçantë prof. Gega i ka kushtuar ushtrimeve të rrokjeve që kanë bashkëtingëllore njëra pas tjetrës, si në leximin e tyre ashtu edhe në shkrim, mbasi këto rrokje paraqesin vështirësi për fëmijët, si p.sh.: *lis - plis, shtati - fshati, guri - gruri*.

III. *Periudha e tretë* lidhet me përforcimin e teknikës së lexim-shkrimit, kjo periudhë ndryshe njihet si *Pasabetarja*. Pas mbarimit të të gjitha shkronjave, në fund të Abetares, prof. Gega ka pasqyruar tekste me tematika nga më të ndryshmet, ku nxënësit ushtrojnë të lexuarit, me anë të copave të leximit që janë dukshëm më të gjata e më të pasura nga ana e brendisë. Një rëndësi të veçantë kanë ushtrimet që ka paraqitur prof. Gega për lexim korrekt, të vetëdijshëm e me shpejtësi mesatare. Nxënësi duhet të ushtrohet të lexojë me intonacionin e duhur e të kuptojë çdo gjë që lexon. Të vazhdohet rregullisht analiza fonetike e rrokjeve dhe e fjalëve të vështira e të reja, duke përdorur mënyrat kryesore të analizës dhe të sintezës. Stërviten që t'u përgjigjen pyetjeve të mësuesit ose atyre në fund të copave të leximit, duke u mbështetur në brendinë e asaj që lexojnë.

Zbatimi me mjeshtëri i metodës analitiko-sintetike në Abetaren e prof. Xhevat Gegës, siguron këto efekte pozitive në mësimin e shkronjave dhe lexim-shkrimin fillestar:

- ndihmon njohjen më të mirë të nxënësve me strukturën fonetike të tekstit, të fjalive e fjalëve.
- lehtëson kuptimin më të mirë të përmbajtjeve që lexon.
- kontribuon edhe për zotërimin më të lehtë të shkathësisë së shkrimit, duke i njohur nxënësit me strukturën grafike të fjalëve e fjalive.

Si rrjedhojë e këtij mbarështrimi, mund të themi se kontributi më i rëndësishëm i profesor Gegës në fushën e arsimit është pasuria e madhe që ai ka krijuar si hartues i Abetares, programeve e teksteve shkollore, që përbëjnë një bazë të fuqishme metodike dhe shkencore për zhvillimin e arsimit fillor, të mesëm dhe atë universitar.

Me hartimin dhe realizimi e Abetares, profesor Gega e vuri Maqedoninë në radhën e vendeve të qytetëruara, duke treguar se ky vend i vogël ka një popull me karakteristikat e tij, me gjuhën dhe zakonet e veta dhe me një thesar të trashëguar nga brezat, prandaj me të drejtë mund të thuhet se prof. Gega i ngriti një ndërtesë madhështore jo vetëm gjuhës e kulturës shqiptare, por edhe mbarë qytetërimin kombëtar.

### **Bibliografia:**

Gega, Xhevat. (1970). *Abetare - zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Gega, Xhevat. (1986). *Abetare - zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Gega, Xhevat. (2000). *Abetare - zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. (1971).

*Metodika e gjuhës amtare për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore*. Prishtinë.

S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica. (1973). *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë.

[https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB\\_Mesonjetorja.pdf](https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB_Mesonjetorja.pdf), shkarkuar me 20.08.2021.

<https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-shefik-osmani-prof-as-dr-njazi-kazazi-abetaret-e-para-shqipe-dhe-trajektorja-historike-e-tyre/>, shkarkuar më 20.08.2021.

[https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha\\_Shqipe/3.pdf](https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha_Shqipe/3.pdf), shkarkuar me 20.08.2021.